

VENDIM
Nr. 1062, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR PAJISJET DHE BASHKËSITË
NËN PRESION” DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 dhe 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion”, sipas tekstit bashkëlidhur që është pjesë e këtij vendimi.
 2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe bashkësive nën presion, referuar në pikën 1, sipas listës bashkëlidhur që është pjesë e këtij vendimi.
 3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve dhe bashkësive nën presion, referuar në pikën 1, me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, të këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama